

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
EMPATHIC TANGO SHPK**

Sot ,ne Durres,me date 03.03.2022 (dymijeenjezetedy) **zj. Elsa Bumbli**, atesia Fadil, shtetase shqiptare, lindur ne Durres, me 01.01.1967 dhe banues ne Durres, rruga “Aleksander Goga”, Pallati 901, shkalla 1, kati 2, Ap.nr.4, zona kadastrale nr.8513, pasuria nr.1/22+1-4, vol.22, faqe 84, mbajtes i dokumentit te identifikimit karte identiteti me G75101640D e cila duke duke vepruar ne cilesine e Ortakut Themelues te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar ” **EMPATHIC TANGO “ Sh.p.k.** me poshte referuar si “ Ortaku Themeltar ”, vendosi aprovimin e ketij Akti Themelimi dhe Statusi sipas termave te meposhtme:

NENI 1

EMRI

Emri I shoqeris eshte “**EMPATHIC TANGO” Sh.p.k**

NENI 2

Forma e shoqerise eshte ajo e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar “sh.p.k”. Sipas nenit 68 te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008. Shoqeria “**EMPATHIC TANGO” Sh.p.k** eshte themeluar nga Zj. Elsa Bumbli e cila pergjigjet per detyrimet e shoqerise deri ne pjesen e kontributit te nenshkruar.

NENI 3

Data e themelimit

Shoqeria eshte themeluar me date 03.03.2022 si Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar “sh.p.k”

NENI 4

Ortaket

Ortaket e shoqerise jane: Zj. Elsa Bumbli ,me shqiptare, i cili zoteron 100 % te kuotave,.

NENI 5

Zyra Qendrore

Zyra qendrore e shoqerise eshte ne adresen rruga “Aleksander Goga”, Pallati 901, shkalla 1, kati 2, Ap.nr.4, zona kadastrale nr.8513,pasuria nr.1/22+1-4,vol.22,faqe 84.

Ne zbatim te nenit 8 pika 2 te ligjit nr.9901 dt 14.04.2008

“Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”,shoqeria tregtare i nenshtrohet dispozitave te ketij ligji.

NENI 6

Objektivi i veprimtarise se shoqerise.

Shoqeria ka per objekt :

Aktivitet ne fushen e eventeve, spektakleve, dans, kercime (tango, latino-amerikano, swing, etj...), organizime kurse vallezimi te ndryshem per dans, kercime (tango, latino-amerikano, swing, etj...).Aktivitete ne fushen e spektaklit, evente kulturore dhe festive, pervjetore, lojra dhe koncerte te ndryshme, aktivitete shplodhese dhe argetuese.

Prodhim dhe tregetim i veshjeve te ndryshme, kepuce si edhe kapele.

Import-Eksport te artikujve industrial.



Shoqeria do te jete e dobishme dhe e nevojshme per arritjen e qellimeve sociale,kombetare dhe evropiane apo te tjera institucione dhe jo-fitimprurese,qofte nga individet,qasje ne koncesione legjislative dhe e kreditit dhe te hyje ne marreveshje me organizatat dhe subjektet publike dhe private.

NENI 7

Kohezgjatja e Shoqerise

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj dhe operon si person juridik me personalitet te plote per te vepruar per nje kohe te pacaktuar.

NENI 8

Te dhenat e identifikimit te personave pergjegjes per administrimin dhe perfaqesimin e shoqerise ne mardhenie me te tretet, kompetencat e perfaqesimit,si dhe afatet e emerimit te tyre.

Personi pergjegjes per administrimin dhe perfaqesimin e shoqerise eshte Zj. Elsa Bumbli me keto te dhena identifikimi :
-lindur me date 01.01.1967 ne Durres dhe banues ne Durres me shtetesi Shqiptare, me Karte Identiteti G75101640D.

Kompetencat e perfaqesimit jane te plota duke i dhene tager administratorit te perfaqesojte shoqerine ne te gjitha marredheniet juridike apo veprime juridike, ku shfaqet Shoqeria "EMPATHIC TANGO" Sh.p.k

Zj. Elsa Bumbli emerohet si administrator dhe perfaqesues i Shoqerise ne marredhenie me te tretet, per nje afat prej 5 vitesh kalendarike, me te drejte ripertesitje.

NENI 9

Ndalime dhe kufizime

Duke qene se Zj. Elsa Bumbli qe gezon njekohesisht edhe cilesine e ortakeve te shoqerise,bazuar ne nenin 7 te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", si persona fizik,ndalohen te lidhin kontrata huaje apo garancie me shoqerine.

Te rregjistrohen ne nje procesverbal i cili perpilohet ne zyren qendrore te Shoqerise.

NENI 10

Specimenti i nenshkrimet (firmes) se personit qe perfaqeson shoqerine perpara te treteve

Emri, Mbiemri Firma

(Elsa Bumbli
E.B.

NENI 11

Vlera e kapitalit themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 (njeqind mije leke).

NENI 12

Numri i pjeseve te kapitalit themeltar te nenshkruar.

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga 1 (nje) kuote.

NENI 13

Vlera nominale e seciles pjese te kapitalit themeltar 100.000 leke (njqind mije leke).

NENI 14

Pjesemarrja ne kapitalin themeltar te nenshkruar

Pjesmarrja ne kapitalin themeltar te nenshkruar eshte 100 %
nga Zj. Elsa Bumbli.

NENI 15

Vlera dhe lloji i kontributit te ortakeve

Vlera dhe kontributi i ortakeve eshte 100.000 leke (njqind mije leke).

Lloji i kontributit te ortakeve eshte ne para, sipas kuptimit te nenit

68 pika 5 te ligjit Nr.9901 date.14.04.2008 "Per Tregetar dhe shoqerite

Tregtare".

NENI 16

Kapitali fillestar i nenshkruar eshte paguar nga ortaket ne menyre te rregullt plotesisht dhe rregullisht.

NENI 17

Ndalimi i konkurences

Ndalimi permendur ne piken 1te nenit 17 te ligjit nr.9901 date.14.04.2008

"Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", mund te shfuqizohet nepermjet nje

autorizimi te posacem, te dhene nga ortaket sipas dispozitave te

nenit 36 te ligjit nr.9901 date.14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite

Tregtare".

NENI 17/1

Ne mungese te nje shfuqizimi te parashikuar nga neni 16 i ketij statuti,
ndalimi i konkureses i parashikuar ne piken 1 te nenit 17 te ligjit nr.9901
date.14.04.2008.

“Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, mbetet ne fuqi deri ne 1 (nje) vit
Kalendarik pas humbjes se ciles te permendur ne piken 1 te nenit 17 te ligjit
Nr.9901 dt.14.04.2008.

NENI 18

Kalimi i kuotave

Kushtezohet kalimi i kuotave te ortakeve te Shoqerise “**EMPATHIC TANGO**” Sh.p.k

- 1-Me te drejten e parablerjes ne favor te ortakeve te tjere te shoqerise.
- 2-Ne rast se e drejta e parablerjes nuk eshte shfrytezuar nga asnje prej
ortakeve te tjere te shoqerise,ateher per kalimin e kuotave sipas nenit 73
pika 1 te ligjit nr.9901 date.14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite
Tregtare”,duhet marre miratimi i shoqerise i cili autorizon keto kalime.
- 3-Fitimi apo kalimi i kuotave me kontrate ,duhet te realizohet ne menyre te
detyrueshme me akt noterial.
- 4-Permbajtja e ketij neni mund te ndryshohet vetem me miratimin e me
shume ortakeve qe perfaqsojne me shume se 2/3 e pjeseve te kapitalit
themeltar.

NENI 19


Shperndarja e fitimeve

Ortaket kane te drejte te ndajne pjeset e fitimit te deklaruar ne pasqyren
financiare te shoqerise.

NENI 19/01

Fitimi u shperndahet ortakeve ne raport me kuotat e zoteruara.

NENI 20



Te drejtat dhe detyrimet e ortakeve

Ortakët e Shoqërisë “**EMPATHIC TANGO**” Sh.p.k në bazë të pikës 3 të nenit 81 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërit Tregtare”, janë përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- 1-Percaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- 2-Ndryshimet e statusit;
- 3-Emrimin e shkarkimin e administratorëve;
- 4-Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të eksperteve kontabel të autorizuar;
- 5-Percaktimin e shpërblimeve për administratoret, likuiduesit dhe ekspertët kontabel të autorizuar;
- 6-Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- 7-Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- 8-Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- 9-Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- 10-Perfaqsimin e shoqërisë në gjykate dhe procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- 11-Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- 12-Nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare, hetim i cili kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës;
- 13-Miraton bilanci vjetor, bilanci e konsoliduar, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe propozimet për shpërndarjen e fitimeve, dokumente këto të paraqitur nga administratori;
- 14-Vendos për nisjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, në përputhje me dispozitat e ligjit dhe të këtij statuti;
- 15-Vendos për likuidimin me një procedurë të përjashtuar sipas nenit 24 të këtij statuti.

NENI 20/1



Regjistrimi i vendimeve te ortakut te vetem

1-Te gjitha vendimet e marra nga ortakët sipas nenit 20 te ketij statuti,regjistrohen ne Regjistrin e vendimeve te ortakeve.

2-Te dhenat e regjistrimit te vendimeve te ortakeve nuk mund te ndryshohet ose te fshihen.

3-Regjistrohen ne vecanti vendimet per :

a-Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te rapoteve te ecurise se veprimtaris;

b-Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;

c-Investime;

Ç-Vendime per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;

4-Vendimet e parregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme.

NENI 21

Te drejtat dhe detyrimet e administratorit

Administratori ka te drejte dhe detyrohet te :

1-Te kryej te gjitha veprimet e administrimit te veprimtaris tregtare te shoqeris, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga ortakët.

2-Te perfaqeson shoqerine tregtare;

3-Te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregjillt te dukumentave dhe te librave kontabel te shoqerise;

4-Te pergatise dhe te nenshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar, raportin e ecurise se veprimtarise dhe propozimet per shperndarjene fitimeve;

5-Te krijoj nje sistem paralajmrimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarvajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqeris;

6-Te kryej regjistrimin dhe te dergoj te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sipas ligjit "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

7-Te raportojne perpara ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqeris tregtare;

8-Nese jane emeruar dy ose me shume administrator, keta e administrojne bashkarisht shoqerin. Ortaket me vendim te vecante, mund te percaktojne qe te kete radhe hierkrike ne administrim, nga administratoret e caktuar duke specifikuar rrethanat e kesaj peparsie ndermjet administratoreve.

NENI 22



Shperblimi i administratoreve

Shperblimi i administratoreve percaktohet me vendim te zakonshme te ortakeve. Shperblimi i administratorit duhet te jete i pershtatshem dhe ne perputhje me detyrat e administratoreve dhe gjendjen financiare te shoqerise. Nese shoqeria eshte ne veshtiresi financiare, ortaket mund te vendosin reduktimin e shperblimit te administratoreve ne masen e pershtateshme. Kriteret e shperblimit, shperblimi individual dhe efekti vjetore i shperblimit te administratoreve ne strukturen e kostove te shoqeris publikohen se bashku me pasqyrat financiare vjetore.

NENI 23

Emrimi i likujduesit

Ne rast se ortaket vendosin per likujdimin e shoqeris ne gjendjen e aftesise paguese, jane te detyruar te caktojne likujduesin, brenda 30 diteve pas prishjes. Ne caktimin e likujduesit duhet te kihet paresysh se ky caktim nuk duhet te paraqes arsye te mjaftueshme qe likujdimi i rregullt i shoqerise mund te cenohet nga likujduesi i caktuar.

NENI 23/1

Te drejtat dhe detyrat e likujduesit

Likujduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij. Kufizimet e caktuara per veprimtarin e likujduesit, mund te vendosen nga ortaket ne aktin e emerimit te likujduesit. Keto kufizime publikohen ne menyre elektronike sipas nenit 61 te ligjit nr.9723 "Per Qendren te Kombetare te Regjistrimit" dhe kane efekt edhe ndaj te treteve duke u quajtur i njohura publikisht ne perputhje me nenin 12 te ligjit nr. 9901. Likuiduesi ka detyre te ftoje kreditorët e shoqerise per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e shoqeris.

Detyrimet kryesore te likuidusve jane:

- 1-Mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise.
- 2-Mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyara.
- 3-Shitja e pasurive te shoqerise.
- 4-Shlyerja e kreditoreve duke respektuar radhen e preferimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.
- 5-Kryerja e veprimeve te reja tregtare ne funksion te mbylljes se nje veprimi te perfunduar.

Kur likuiduesit vene re se pasuria e shoqeris tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e pretendimeve te ngritura nga kreditorët, likuiduesi pezullon procedurat e likuidimit dhe i kerkon gjykates nisjen e procedurave te falimentimit.

NENI 24

Shperndarja e aktiveve

Pas shlyrjes se detyrimeve ndaj kreditoreve, likuiduesi i shperndan ortakeve aktivet e mbetura.

NENI 25



Likuidimi i thjeshtezuar

Me vendimin e tyre, ortakët mund të vendosin për likuidimin e përjashtuar. Me marrjen e këtij vendimi dhe regjistrimin e tij të rregullt në regjistrimin e vendimeve, sipas kritereve të këtij statuti, ortakët janë të detyruar të deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqëris ndaj kreditorëve janë shlyerë e janë rregulluar të gjitha mardheniet me punëmarrsit.

Administratori dhe ortakët janë përgjegjës solidarisht, për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtezuar.


NENI 26

Depozita e fundit

Ky status hyn në fuqi me regjistrimin e tij pranë Qendrës Kombëtare të

Regjistrimit.

Miratuar me vendimin e ortakëve Zj. Elsa Bumbli date 03.03.2022.

A handwritten signature in blue ink, reading 'Elsa Bumbli', is written over a horizontal dashed line. The signature is stylized and includes a large flourish at the end.